

BEQIR META**PËRPJEKJET PËR KONSOLIDIMIN E INSTITUCIONEVE
KOMBËTARE (1925-1935)**

Qysh në ditët e para të veprimtarisë së saj, administrata e Zogut u përpoq tu jepte zgjidhje efektive disa problemeve të mprehta që ishin shfaqur në vitet 1920–1924, të cilat pengonin konsolidimin e shtetit dhe procesin e afirmimit të kombit shqiptar.

Njëri nga këto probleme ishte ai i konsolidimit dhe kombëtarizimit të sistemit arsimor. Në Shqipëri ende vijonte funksionimi i shumë shkollave të huaja, të cilat frekuentoheshin nga nxënës të kombësisë shqiptare dhe që jepnin një edukatë që nuk shkonte në favor të kultivimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare, aq e rëndësishme për forcimin e unitetit kombëtar. Në këtë fushë, vendi po përballlej me ndërhyrjen dhe konkurrencën e fuqishme të shteteve të huaja dhe në radhë të parë të shteteve fqinjë, të cilët po përpiqeshin të ruanin privilegjet që kishin pasur gjatë periudhës së sundimit osman në edukimin e rinisë shqiptare.

Një ndër shfaqjet e kësaj ndërhyrje ishte edhe nxitja e largimit të djemve nga Shqipëria për të mësuar në shkolla të huaja, kryesisht në ato greke. Prefektura e Gjirokastrës i kërkoi Ministrisë së Brendshme që të ndalohej dalja e nxënësve jashtë Shqipërisë në qoftë se ata nuk e kishin mbaruar shkollën fillore ose plotore gjashtë rëndëshe. Ajo konstatonte se vendimet e mëparshme të Këshillit të Ministrave, nr. 431 dhe 496, kishin lënë shumë shtigje që pengonin arritjen e këtij objekti¹. Për të kundërbalancuar propagandën greke në këtë qark, e cila ishte shkaktare kryesore e këtij fenomeni, kërkohesh të merreshin masa energjike për përmirësimin e gjendjes së shkollave shqipe, hapjen e shkollave të tilla në ato katunde që nuk kishin dhe dhënia e bursave në një shkallë të gjerë prej qeverisë, veçanërisht për fëmijët e fshatrave të varfër. Prefektura

¹ *Arkivi Qendror i Shtetit* (më tej: *AQSh*), Fondi: MPB, viti 1925, dos. 102, fl.1. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 20 janar 1925.

pohonte: “Gjersa shkollat kombëtare do të jenë në gjendjen e sotme dhe gjersa personeli i Liceut të Gjirokastrës do të ishte i mangët e bursat do të ishin të kufizuara, prindërit, në çdo rast, do të përpiqeshin t’i dërgonin fëmijët e tyre në shkollat e jashtme, jo se u pëlqente të gjithëve edukimi i huaj, por sepse ishin të detyruar ta pranonin për të mos lënë të verbër fëmijët e tyre”².

Madje kishin ndodhur edhe fenomene të tilla, si ai i fshatrave shqiptare Frashtan dhe Lugar që po kërkonin hapjen e shkollës greke. Këto dy fshatra që banoreshin tërësisht nga shqiptarë, ndodheshin në mes të katundeve grekofone të Dropullit. Ata kishin pasur gjithmonë marrëdhënie me katundet grekofone përreth dhe fëmijët e tyre ishin martuar me vajza greke. Këshilli i Ministrave nuk e miratoi kërkesën e tyre për hapjen e shkollave greke. Kështu që këto dy fshatra, me qëllim që të ushtronin presion ndaj autoriteteve shtetërore, nuk i dërgonin fëmijët e tyre në shkollat shqipe.³

Gjithashtu autoritetet shqiptare kishin informacione se Greqia vijonte të paguante mësues grekomanë në Prefekturën e Gjirokastrës, megjithëse këta merrnin rroga si mësues edhe prej shtetit shqiptar⁴.

Autoritetet vendore të arsimit në Gjirokastrë u alarmuan nga përpjekjet që po bënin deputetët grekofonë në parlamentin shqiptar për të futur gjuhën greke edhe në katundet shqiptare. Inspektoria e Arsimit të Gjirokastrës e konsideronte këtë kërkesë si zbatimin e politikës greke, si “ngjalljen e një nepërke me dy kokë”, e cila, përveç greqizimit të shkollës shqipe, synonte edhe varësinë e Kishës Autoqefale Shqiptare nga Patriarkana e Stambollit dhe zbatimin e Protokollit të Korfuzit⁵. Po kjo Inspektori njoftonte se po bëhej një propagandë e madhe që fëmijët e moshave 12–14 vjeç nga Pogoni, Dropulli e Dhrovjani të studionin në internatin grek të Voshtinës. Kështu po shtoheshin arratisjet e djemve

² *Po aty*.

³ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1925, dos.12, fl.5. Inspektoria e Arsimit Gjirokastrë - MA, 28 janar 1925.

⁴ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1925, dos.166, fl.95. MPB - Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, 7 maj 1925.

⁵ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1925, dos.12, fl.17-19, 52. Raporte të Inspektorit të Arsimit, Gjirokastrë, Jani Minga - Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, Tiranë, 13 gusht dhe 10 shtator 1925.

jashtë kufirit për të studiuar në këtë shkollë⁶. Delvina cilësohej si strofka e veprimit antikombëtar, ku po bëheshin përpyjekje për zbatimin e sistemit të kantoneve në Shqipëri. Prandaj propozohej që kjo strofka të zhdukej me ngritjen e një gjysmë gjimnazi në Delvinë dhe jo në Dhrovjan. Forma e kësaj shkolle duhej të ishte kombëtare, me gjuhët klasike dhe gjuhën shqipe⁷.

Qeveria mori masa për goditjen e propagandës greke dhe filogreke që kishte zënë vend në ndonjë organ shtypi. Në këtë kuadër u mbyllën fletoret “Liria” dhe “Tirana”, prona të avokatit Vasil Dilo me motivacionin se “nëpërmjet tyre, ai ishte munduar gjithmonë për të diskredituar kombin e shtetin shqiptar në interes të huajve prej të cilëve ai paguhej, si dhe për të ngatërruar çështjen e Kishës Ortodokse Autoqefale dhe të shkollave, duke propozuar si gjuhë zyrtare, gjuhën greke dhe shumë sende të tjera si këto që cenojnë independencën tonë.”⁸

Qeveria mori masa efektive për të hetuar mbi aktivitetet që po zhvillonin organizatat vorio–epirote dhe për lidhjet që po krijonin ato me disa refugjatë politikë shqiptarë, të cilët kishin qenë përkrahës të qeverisë së Nolit⁹.

Në vitin 1926 agjencia greke në Shqipëri bëri përpyjekje të ethshme për të çelur një shkollë greke në Sarandë. Kryetari i bashkisë së Sarandës, Koço Harito, në bashkëpunim me senatorin Petro Harito dhe me deputetin grekofon Boxhori, shkuan në konsullatën greke të Sarandës dhe morën prej saj udhëzime për hapjen e një shkolle greke në Sarandë e për futjen e gjuhës greke në shkollat shqipe nën maskën e fesë. Ata thirrën në fshehtësi disa banorë grekofonë të Sarandës, të cilët nënshkruan një lutje dërguar qeverisë për çeljen e shkollës¹⁰. Në fjalimin që mbajti në oborrin e Mitropolisë së Gjirokastrës, me rastin e ardhjes së Mitropolitit grek, Krisanthit, deputeti i Vlorës Simonidhi, mik i Boxhorit, deklaroi se

⁶ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1925, dos.102, fl.3. Inspektori i Arsimit Gjirokastrë, Jani Minga - Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, Tiranë, 25 nëntor 1925.

⁷ *Po aty*, dos.12, fl.17-19. Jani Minga - Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, Tiranë, 13 gusht 1925.

⁸ *Po aty*, dos. 784, fl.4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, 8 shtator 1925.

⁹ *Po aty*, dos. 46, fl.2. MPB - Prefekturave Korçë e Gjirokastrë, 6 mars 1925.

¹⁰ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1926, dos. 140, fl.1-3. Inspektori i Arsimit, Gjirokastrë, Jani Minga - Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, 30 tetor 1926.

“çështja e kishës autoqefale mori një fund të pëlqyeshëm sepse gjuha greke do të jetë jo vetëm si gjuhë meshimi në të gjitha kishat, por do të mësohet edhe në shkollat e katundeve të krishtera shqipfolëse si gjuhë fetare”¹¹. Pas kësaj lutje, qeveria bëri një lëshim të madh dhe mjaft të çuditshëm. Ajo dha lejen për hapjen e një shkolle greke në Sarandë, në të cilën do të mësonin vetëm fëmijët e grekofonëve, sipas rregullave të shtetit që ishin në fuqi.¹² Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit e konsideroi të gabuar këtë vendim pasi, siç njoftonte ajo, në Sarandë nuk ekzistonte një komunitet grekofon dhe nuk kishte nxënës grekofonë, përveç katër djemve dhe dy vajzave që ndiqnin shkollën shqipe të qytetit. Tregtarët grekofonë të Sarandës që kishin bërë lutjen për hapjen e shkollës greke, nuk ishin banorë të Sarandës dhe nuk i kishin familjet e tyre në këtë qytet. Ata banonin në katundet grekofone, ku funksiononin shkollat greke. Për këto arsye, Drejtori i Arsimit të Gjirokastrës, Jani Minga refuzoi ta zbatojë këtë vendim, duke argumentuar se çelja e kësaj shkolle binte në kundërshtim me artikullin VI të Deklaratës së Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve për minoritetet. Ai kërkoi anulimin e vendimit të Këshillit të Ministrave.¹³

Edhe Nënprefektura e Delvinës kërkoi që të mos hapej shkolla greke në Sarandë sepse ajo do të tërhiqte gjithë djemtë ortodoksë shqiptarë të shkollave shqipe.¹⁴ Mirëpo konsulli grek i Sarandës veproi energjikisht dhe me shpejtësi. Ai thirri gjithë tregtarët grekofonë të Sarandës, të cilët i nxiti të financonin çeljen e shkollës dhe të ndihmonin që në atë shkollë të shkonin edhe fëmijët e fshatrave përreth.¹⁵

Çeljen e shkollës greke në Sarandë e kundërshtoi shumica dërrmuese e popullsisë së qytetit, e cila ishte shqiptare.¹⁶

Në dy vitet e para, kur regjimi i ri ishte ende i pastabilizuar, agjentura greke përfitoi nga situata e krijuar për të goditur çdo tendencë të afirmimit kombëtar të popullsisë, shtetit dhe institucioneve shqiptare

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*, Fondi: Kryeministria, viti 1926, dos. IV-150, fl.12. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 425, datë 15 dhjetor 1926.

¹³ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1926, dos. 140, fl. 4-6. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit - Ministrisë së Drejtësisë.

¹⁴ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1926, dos. 266, fl.9. Nënprefektura e Delvinës - MPB, 23 dhjetor 1926.

¹⁵ *Po aty*, fl.10. Nënprefektura Delvinë - MPB, 29 janar 1927.

¹⁶ *Po aty*, dos.618, fl.1-2. Letër e banorëve të Sarandës dërguar MPB.

në prefekturat e Korçës e të Gjirokastrës. Gjendjen e krijuar e pasqyron qartë një raport i Prefekturës së Gjirokastrës¹⁷, i cili vinte në dukje se elementit ortodoks të atij qarku, megjithëse po dëshmonte solidaritet me regjimin e ri, i mungonte ideali kombëtar. Disa ortodoksëve “emri i Kishës Autoqefale Shqiptare u tingëllon keq në vesh, ashtu si kripa në sy. Qëllimi i tyre është që çështja e kishës të kthehet në gjendjen që ishte para Kongresit të Beratit”. Kishte mjaft kohë që në kisha nuk po zihej në gojë kisha autoqefale dhe as shteti shqiptar. Gjuha shqipe që kishte filluar të dëgjohej më parë në meshë jo vetëm ishte zhdukur, por po përmendej edhe emri i dhespotit Vasilios, i cili kishte qenë protagonist i “autonomisë epirote”. Përgjithësisht, anëtarët e Këshillit të Mitropolisë së Gjirokastrës po demonstironin ndjenja greke dhe influencoheshin nga politika greke. Ata zhvillonin takime të shpeshta me zëvendëskonsullin grek të Sarandës. Mitropolia, me veprimet e saj, nuk ndryshonte nga koha e regjimit turk, kur vepronte vazhdimisht në marrëveshje me konsullatat greke. Prefektura e Gjirokastrës informonte se Kryesia e Kishës Autoqefale kishte shkarkuar Sekretarin e Mitropolisë së Gjirokastrës, Jani Dadon, i cili ishte një element i dyshimtë dhe kërkonte emërimin e një shqiptari patriot në vend të tij. Urrejtjen kundër kishës autoqefale e ushqenin edhe disa deputetë e senatorë të qarkut të Gjirokastrës, të cilët vepronin tërthorazi. Ata i kishin kërkuar Prefektit të Gjirokastrës që të punohej për një kongres të dytë kishtar, i cili të plotësonte statutin e kishës. Këta senatorë e deputetë udhëtonin shpesh në Korfuz. Përrjashtim bënte këtu vetëm patrioti Petro Poga¹⁸.

Në vijim të përpjekjeve për të goditur autoqefalinë e kishës shqiptare, grekët e shtrinë aktivitetin e tyre deri në Berat. Një prift grekofon nga Gjirokastra zhvilloi një meshë në gjuhën greke në kishën e lagjes Goricë të këtij qyteti. Në këtë ngjarje ishte implikuar edhe Dhespoti i Beratit. Prapa këtij veprimi qëndronte ish-ministri grek në Durrës, Panurajas. Synimi ishte që të bëhej një sprovë për të futur gjuhën greke në Kishën Autoqefale Shqiptare. Autoritetet shtetërore, duke zbatuar Statutin e Kishës Autoqefale, e dëbuan jashtë Beratit priftin grekofon, por kjo shkaktoi shqetësime e tension në një pjesë të popullsisë ortodokse të Beratit¹⁹.

¹⁷ *Po aty*, dos.34, fl.18. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 7 nëntor 1926.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, dos.34, fl.63. Prefekti i Beratit, Jella - MPB, 26 janar 1926.

Për të ruajtur karakterin kombëtar të Kishës Autoqefale, Prefektura e Korçës sugjeroi që me formimin e Sinodit Episkopal të ruhej mbizotërimi i elementit kombëtar shqiptar, duke iu referuar shembullit të Malit të Zi dhe të Patrikanës së Jerusalemit, të cilat ishin të përbëra në shumicë nga priftërinj të thjeshtë. Për këtë arsye, Prefektura e Korçës kërkoi që Vasil Janidhit, i sugjeruar si kandidat për të drejtuar njëri nga dioqezat ortodokse, të mos i jepej ky post, pasi ai ishte me origjinë kucovllahë dhe nipi i dhespotit Jerotheu²⁰.

Qeveria greke, duke punuar me objektivin që të hidhte të krishterët e Jugut kundër shtetit shqiptar, qysh në vitin 1924 kishte çelur në Filat dy shkolla me internate, në të cilat studionin falas 35% e të krishterëve shqiptarë nga Shqipëria e Jugut. Ajo po u jepte fshehtazi rroga mësuesve grekofonë që ishin në rajonet e Çamërisë, Delvinës, Gjirokastrës dhe Himarës, sigurisht kundrejt shërbimeve që këta i bënin politikës greke. Kështu, për shembull, mësuesit të fshatit Leshnicë të Delvinës i jepej një rrogë mujore prej 1.500 dhrahmish²¹.

Në Prefekturën e Korçës kishin filluar të lulëzonin përsëri disa shkolla të fshehta private në gjuhën greke. Prefektura mori masa për ndalimin e tyre²². Por Ministria e Brendshme udhëzoi që të lejoheshin të vijonin punën e tyre tre vajza greke që po jepnin mësim nëpër shtëpi privatisht²³. Katër muaj më vonë, Prefektura e Korçës i kërkoi përsëri Ministrisë së Brendshme që të mos jepeshin leje për mësim private në gjuhën greke sepse kështu do të dëmtoheshin interesat arsimore të shtetit²⁴.

Në vitin 1928 pothuajse ishin shuar përpjekjet dhe tentativat greke e grekofile për të penguar afirmimin e identitetit kombëtar shqiptar. Kjo i dedikohet stabilizimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar.

Megjithatë vërehej ndonjë rast i veçantë i këtyre shfaqjeve. Kështu, në prill të vitit 1928 tre persona nga Gjirokastra (një tregtar, një

²⁰ *Po aty*, fl.87. Prefektura e Korçës - MPB, 1 qershor 1926.

²¹ *Po aty*, dos. 110, fl.2. Nënprefekti i Çamërisë, Hiqmet Delvina - MPB, 30 shtator 1926.

²² *Po aty*, dos.268, fl.1. Prefektura e Korçës - MPB, 25 shkurt 1926.

²³ *Po aty*, fl.6. MPB - Prefekturës së Korçës, 19 prill 1926.

²⁴ *Po aty*, fl.18. Prefektura e Korçës - MPB, 4 gusht 1926.

rrobaqepës dhe një mësues privat i gjuhës greke) kundërshtuan disa djem shqiptarë që donin të meshonin në gjuhën shqipe²⁵.

Ndërsa në kishat ortodokse të Nënprefekturës së Bilishtit nuk po përdorej gjuha shqipe as në mesha, as në formalitetet fetare. Kjo nuk vinte si rezultat i dëshirave të popullsisë, por ishte nxitur nga disa anëtarë të Komisionit Organizator Kishtar të Bilishtit dhe të Hoçishtit²⁶.

Përpara qeverisë së Zogut u rishfaq edhe çështja e Himarës. Në këtë kohë, një grup himarjotësh, me nxitjen e propagandës greke, nuk pranonin të njihnin Kishën Autoqefale Shqiptare dhe zëvendës mitropolitin e Gjirokastrës që kishte dërguar kjo kishë për të kontrolluar llogaritë e kishës së Himarës. Komisioni kishtar i Himarës nuk pranonte t'i dorëzonte atij llogaritë e kishës²⁷. Llogaritë e pasurisë kishtarë, deri në këtë kohë, kishin qenë në dorën e një komisioni prej 5 vetash, i zgjedhur prej dy grupeve (venomistëve dhe patriotëve). Grupi patriotik shqiptar, me iniciativën e Anargjir Nushit, kërkoi nga Kisha Autoqefale emërimin e një përfaqësuesi fetar për kontrollimin e llogarive të kishës. Për këtë qëllim u dërgua në Himarë zëvendësmitropolit i Gjirokastrës, i cili kërkoi llogaritë prej Komisionit. Por anëtarët e këtij komisioni, duke dashur të mbulonin abuzimet e tyre dhe për të kundërshtuar formimin e një dege të Kishës Autoqefale në Himarë, nuk iu përgjigjën urdhrave të zëvendësmitropolitit, At Thanasit dhe kryepriiftit Spiro Kokaleshit²⁸.

Prefektura e Vlorës propozoi që zëvendësmitropolitin dhe kryepriiftin, për të cilët kishte ankesa se ishin vënë pa dëshirën e popullit, të largoheshin përkohësisht dhe pa humbur kohë të emëroheshin klerikë të tjerë. Kështu të formohej kisha autoqefale, duke marrë edhe llogaritë nga komisioni abuzues. “Ndërsa atyre që kundërshtonin principet e përgjithshme të elementit ortodoks mbi formimin e Kishës Autoqefale, t’u dëftohej grushti”²⁹.

Për themelimin e Kishës Autoqefale Shqiptare në Himarë u bë një mbledhje e gjithë pleqësisë dhe parisë së Nënprefekturës së Himarës me Mitropolitin e Gjirokastrës. Në këtë mbledhje ata njohën Kishën

²⁵ *Po aty*, viti 1928, dos.39, fl.162. Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë - MA, 23 prill 1928.

²⁶ *Po aty*, fl. 168-169. Nënprefektura e Bilishtit - Prefekturës së Korçës, 2 maj 1928.

²⁷ *Po aty*, viti 1925, dos-58, fl.41. Prefektura e Vlorës - MPB, 9 shtator 1925.

²⁸ *Po aty*, fl.58. Prefektura e Vlorës - MPB, 16 shtator 1925.

²⁹ *Po aty*.

Autoqefale Shqiptare dhe emëruan si përfaqësues të saj për Himarën, Stavro Liton. Brenda 10 ditëve do të emëroheshin edhe anëtarët e Këshillit Kishtar³⁰. Kështu çështja e njohjes së Kishës Autoqefale po shkonte drejt zgjidhjes. Mirëpo në këtë kohë erdhi në Himarë nga Korfuzi, Jani Milo, i cili e përçau popullin e Himarës dhe e minoi progresin e arritur. Prefektura e Vlorës, duke e konsideruar të rrezikshme propagandën dhe lidhjet e tij me Greqinë, kërkoi internimin e tij³¹.

Por Ministria e Brendshme nuk e miratoi këtë kërkesë. Ajo porositi që të mbahej një qëndrim i matur, duke e këshilluar atë që të mos e pengonte njohjen e Kishës Autoqefale nga i gjithë populli i Himarës. Në rast se nuk bindej, do të internoheshin dy persona të tjerë që kishin penguar Kishën Autoqefale, me qëllim që Jani të vihej përpara presionit shtetëror³². Meqë rezistenca e grupit venomist filogrek kundër Kishës Autoqefale vazhdoi, Gjyqi i Paqit i Nënprefekturës së Himarës burgosi Jani Milon dhe disa kundërshtarë të tjerë të kishës autoqefale. Vendimi i gjyqit e cilësoi veprimtarinë e tyre si krim politik³³. Prefektura e Vlorës besonte se me këtë vendim të prerë të gjyqësorit, çështja e kishës do të zgjidhej pozitivisht dhe do t'u pritej hovi intrigave dhe aktiviteteve antikombëtare.

Pas këtyre masave, paria e Himarës i dërgoi një letër me 40 nënshkrime Kryesisë së Kishës Autoqefale, në të cilën shfaqej bindja e plotë dhe respekti për Kishën Autoqefale Shqiptare. Pra ishte e qartë se shkaktari kryesor i përçarjes së popullit të Himarës dhe i mosnjohjes së KOASH kishte qenë Jani Milo dhe shokët e tij. Prefektura e Vlorës informonte se pas burgosjes së tij, populli ishte i qetë dhe mbështeste bashkimin me KOASH, ndërsa burgimit të Jani Milos nuk i jepej ndonjë rëndësi e madhe prej popullit dhe influenza e tij ishte thyer³⁴.

Mirëpo autoritetet shqiptare, si në shumë raste të tjera, synonin ta ulnin tensionin dhe të mos merrnin masa të ashpra shtrënguese ndaj elementëve grekofilë. Për këtë arsye, Prefektura e Vlorës propozoi lirin e Jani Milos dhe shokëve të tij³⁵. Me dekret të A. Zogut, Jani Spiro Milo, Jorgji Bollano, Miço Karaj, Petro Konini, Pano Llazari, Thanas Zoto, që

³⁰ *Po aty*, fl. 66. Prefektura Vlorë - MPB, 8 tetor 1925.

³¹ *Po aty*, fl. 75. Prefektura Vlorë - MPB, 30 tetor 1925.

³² *Po aty*, fl.74. MPB - Prefekturës Vlorë, 31 tetor 1925.

³³ *Po aty*, fl.77. Prefektura e Vlorës - MPB, 14 nëntor 1925.

³⁴ *Po aty*, fl.89. Prefektura e Vlorës - MPB, 19 dhjetor 1925.

³⁵ *Po aty*, fl.88. Prefektura e Vlorës - MPB, 17 dhjetor 1925.

ishin të burgosur në Vlorë, si dhe Thanas Bollano që ishte i arratisur, u falën³⁶.

Suksesi i përkohshëm që u arrit për pranimin e kishës autoqefale shqiptare, nuk ishte një provë se propaganda greke në Himarë i dorëzoi armët. Qeveria greke ishte aktive dhe po bënte subvencionime të shumta për këtë qëllim. Ajo kishte dhënë 17 bursa për nxënësit e Himarës, me ndërhyrjen e Spiro Milos, zyrtar i shtetit grek dhe vëllait të tij Jani Milos³⁷. Qeveria greke u jepte çdo vit bursa 30 nxënësve për të studiuar në Athinë, Korfuz dhe në Serviat të Maqedonisë greke. Jani Milo dërgonte në këto shkolla bij të familjeve të pasura e me influencë që ishin miq të tij, me qëllim që të shtonte influencën e vet në këtë krahinë. Këtë influencë ai e përdorte, në çdo rast, kundër shtetit shqiptar³⁸. Duke parë rrezikun e kësaj politike, Ahmet Zogu urdhëroi ndalimin e djemve të Himarës për të studiuar në shkollat greke me bursat e shtetit grek dhe dërgimin e tyre për të studiuar në internatin e Vlorës me bursa të shtetit shqiptar³⁹.

Masat që mori shteti shqiptar për kombëtarizimin e arsimit në Himarë filluan t'i japin rezultatet e tyre. Në vitin 1928 autoritetet e larta arsimore të vendit konstatonin se ato kishin qenë efektive në shkollat e Dhërmiut, Himarës, Palasës, ashtu si dhe në qendrën e Delvinës “të cilat tashmë paraqiteshin me një fytyrë më tepër shqiptare se sa greke” sepse nxënësit po i zhvillonin mësimet në gjuhën shqipe, ndërsa i gjithë dokumentacioni i shkollës mbahej në gjuhën shqipe⁴⁰.

Mirëpo, nga ana tjetër, autoritetet shqiptare e ndjenin presionin e fortë të propagandës greke që drejtohej nga Mitropoliti i Janinës, Spiridhoni, i cili vepronte si drejtues i arsimit grek në pjesën e Epirit grek dhe kishte në dorë jo vetëm një shumë të madhe të hollash të akorduara nga qeveria greke, por edhe gjithë llasat (donacionet) e shqiptarëve ortodoksë që gjendeshin në Greqi dhe në Amerikë. Me iniciativën e tij ishin ngritur pranë kufirit shqiptar konvikte për djem, si: në Voshtinë,

³⁶ *Po aty*, fl.91. Dekret i Kryetarit të Republikës, A. Zogu, 24 dhjetor 1925.

³⁷ *Po aty*, dos. 102, fl.3. Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë - MPB, 18 tetor 1925.

³⁸ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1925, dos.12, fl.55. Telegram i Anargjir Nushit - A.Zogut, 25 gusht 1925.

³⁹ *Po aty*, fl.17. Urdhër i A.Zogut - Ministrisë së Drejtësisë, 12 tetor 1925.

⁴⁰ *Po aty*, viti 1928, dos. 5, fl. 7-11. Inspektoria e Arsimit, Tiranë - MA, 9 qershor 1928.

Konicë, Vurbjan e Korfuz, ndërsa për vajza ishin ngritur shkolla normale në Filat e Janinë. Në këto konvikte ishin pranuar edhe shumë djem nga Himara, si bursistë të qeverisë greke. Vetëm në konviktin e Korfuzit ishin 40 djem nga Himara⁴¹.

Shkolla e Palasës, me 60 nxënës në katër klasa, funksiononte mirë. Veprimi i saj, nga pikëpamja e kërkesave të arsimit kombëtar, vlerësohej si i pëlqyeshëm. Të gjitha mësimet jepeshin shqip, ndërsa greqishtja mësohej një orë në ditë. Shkolla e Dhërmiut që kishte 111 nxënës në katër klasa, funksiononte mirë dhe kishte një trupë mësimore të aftë. Edhe këtu të gjitha mësimet jepeshin shqip, ndërsa greqishtja jepej si gjuhë dhe në lëndën e fesë. Po kjo gjendje ishte edhe në shkollat mashkullore e femërore të Himarës, të cilat kishin respektivisht nga 119 e 87 nxënës. Por në shkollën femërore, meqë mësuesja nuk dinte greqisht, mësimet jepeshin të gjitha në shqip.

Inspektoria e Arsimit, e qartë për karakterin shqiptar të Himarës, jepte edhe disa argumente interesante. Ajo theksonte se mbiemrat e familjeve të para të Dhërmiut, Palasës e Himarës, si: Dhimaj, Zhupaj, Milaj dhe Ninaj ishin mbiemra çetash që ndesheshin edhe në Progonat të Kurveleshit e në Kaninë. Shpërngulja e tyre në katundet e bregut ndodhi në një kohë kur feja myslimane filloi të depërtojë në Labëri e në Kurvelesh. Gjuha greke në kishë u ruajt nga kleri si gjuhë ngushëllimi, shprese e shpëtimi, por edhe si gjuhë tregtie që zhvillohej me banorët e ishujve Jonianë dhe si gjuhë e jetës së piratëve. Ndërsa gjuha shqipe si gjuhë amtare, nuk u shua nga vatra e shtëpisë. Ajo mbeti shpuzë e prush i mbuluar me hi. Kjo ishte arsyeja që ajo kërkonte forcimin organizativ dhe të karakterit kombëtar të shkollave të Himarës. “Puna e madhe, puna kombëtare e arsimit sot është që Bregut t’i ndërrojmë fytyrën e sotme e t’i japim atë që ka pasur herët, fytyrën e shqipes. Por këtë e bën vetëm femra, si arsimitare në shkollat femërore”⁴².

Lëvizja për autoqefalinë e kishës ortodokse shqiptare në vitet ‘20 ishte një fakt historik. Por studiuesi Roberto Moroco dela Roka (Roberto Morozzo della Rocca) tërheq vëmendjen se kjo lëvizje nuk duhet mbiçmuar dhe absolutizuar, duke e konsideruar këtë fazë historike si një pasojë të natyrshme të zhvillimit të nacionalizmit shqiptar që po shkonte

⁴¹ *Po aty*.

⁴² *Po aty*, viti 1928, dos. 5, fl.13. Raport i Inspektorisë së Arsimit-Tiranë, mbi shkollat grekofone, 15 korrik 1928.

duke u afirmuar gjithnjë e më shumë midis shqiptarëve ortodoksë⁴³. Për këtë konkluzion ai përmend raportin e legatës britanike në Shqipëri, në të cilin thuhet: “Në popullsinë ortodokse, pak veta janë haptas helenistë në simpatitë e tyre dhe separatistë nga prirja (domethënë në favor të aneksimit të viseve jugore ortodokse shqiptare nga Greqia). Shumica dërrmuese, megjithëse nuk ka tendenca separatiste në lëmin e fesë, është e kënaqur ashtu siç është dhe nuk dëshiron të përmbysset një rregullim shekullor, në bazë të të cilit kontrolli i kishës ortodokse ka qenë ushtruar nga Patrikana Ekumenike nëpërmjet peshkopëve dhe klerit të emëruar prej saj. Madje midis nacionalistëve të flaktë me fe ortodokse, shumë janë kategorikisht kundër një transferimi të besnikërisë së tyre hierarkike, sepse i kuptojnë vështirësitë praktike që duhen kapërcyer përpara se një kishë shqiptare të mund të ndërtohet mbi bazën e materialit të varfër të disponueshëm. Sidoqoftë reformatorët, aspak të dekurajuar nga fakti që masa e besimtarëve nuk ushqente simpati për objektivat e tyre, kanë filluar një fushatë të ashpër në favor të pavarësisë fetare, dhe duke qenë një pakicë fjalamane që i kundërvihet një shumice apatike, i kanë realizuar me sukses synimet e veta”⁴⁴. Ky raport i legatës britanike nuk duhet të merret si i mirëqenë, pasi britanikët nuk kishin instrumente të masnën realisht përkrahjen e kishës autoqefale shqiptare nga popullsia ortodokse. Nga ana tjetër është e sigurt se nëse popullsia ortodokse shqiptare, në shumicën e saj ose në një proporcion të rëndësishëm, do të kishte qenë vendosmërisht kundër kishës autoqefale, asnjë qeveri, jo më në vitin 1923 kur situata politike ishte jo e stabilizuar, por as edhe më vonë kur shteti shqiptar hodhi hapa të rëndësishëm drejt stabilizimit nën drejtimin e A. Zogut, nuk do të kishte qenë në gjendje të impononte kishën autoqefale në kundërshtim më dëshirat e popullsisë. Ajo nuk do të mund ta bënte këtë, aq më tepër, në kushtet e një presioni të fortë e permanent nga ana e Greqisë, i cili ishte evident dhe ushtrohej në të gjitha drejtimet. Faktet e përmendura në këtë artikull provojnë se, megjithëse shumica e popullsisë ortodokse e përkrahte autoqefalinë, kishte ende mjaft ortodoksë shqiptarë që e shihnin atë me skepticizëm ose ishin apatikë, pasi gjendeshin ende nën ndikimin e fortë të propagandës greke dhe i frikësoheshin mallkimeve të Fanarit. Këtu nuk

⁴³ Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, Shtëpia botuese “Elena Gjika”, Tiranë, 1994, f. 55.

⁴⁴ Foreign Office (më tej: FO), 371/13560 (C 2310/2310/90). Raport vjetor i Hodgsonit drejtuar Çambërleit, 26 mars 1929.

duhet ngatërruar tendenca me vështirësitë e momentit. Ashtu si në shumë drejtime të tjera edhe në sferën religjioze po ndodhte procesi i formimit të institucioneve kombëtare, por ndoshta për vetë natyrën specifike që kishte çështja kishtare, transformimi ishte më delikat dhe më i vështirë. Sidoqoftë duhet theksuar me bindje të plotë se masat që po merrte qeveria shqiptare për forcimin e karakterit kombëtar të institucioneve fetare, arsimore, kulturore etj. në Shqipëri nuk kishin asnjë ngjashmëri me politikat asimiluese që kishin marrë fqinjët ballkanikë ndaj pakicave të tyre, qoftë për nga qëllimet dhe objektivat e këtyre masave, qoftë edhe nga mjetet që ishin përdorur për t'i realizuar ato.

Pak muaj pas Kongresit të Beratit, një problem praktik me një rëndësi më të madhe bëri që të kalonte në plan të dytë përcaktimi i çështjeve që ishin më shumë doktrinare. Ky ishte problemi i shtetasve shqiptarë ortodoksë që nuk e quanin veten si pjesëtarë të kombësisë shqiptare, për të cilët shpallja e autoqefalisë së kishës shqiptare ishte një nxitje e mëtejshme për të kërkuar mbrojtës të jashtëm. Këto pakica ishin: *së pari*, pakica greke, *së dyti*, një grup i vogël njerëzish nga pakica arumune dhe pakica malazeze në Shkodër. Në bazë të marrëveshjes së Shqipërisë me LK, këto pakica kishin të drejtë të kishin priftërinj të kombësisë e të gjuhës së vet. Por ata nuk ishin të kënaqur me kaq. Ata dëshironin të ruanin *status quo*-në e vjetër të kishës ortodokse në gjithë Shqipërinë dhe kundërshtuan autoqefalinë e saj. Në këtë mënyrë, si në rrallë vende të tjera të botës, në Shqipëri këto pakica po përpiqeshin të pengonin konsolidimin e institucioneve kombëtare të shumicës, që ishte popullsia shqiptare. Pra, për arsye të rrethanave specifike historike në të cilat ishte krijuar e po zhvillohej shteti shqiptar, pakicat, jo vetëm kishin qenë në gjendje të mbronin me sukses të plotë identitetin dhe institucionet e tyre, por si në rrallë shtete të botës, kishin kaluar në pozita ofensive për të bllokuar proceset e konsolidimit të shtetit dhe institucioneve kombëtare.

Se sa i vështirë ishte procesi i realizimit të autoqefalisë e tregon dhe episodi i mëposhtëm: Një muaj para Kongresit të Beratit, Visarion Xhuvani kishte mundur të siguronte nga qeveria e Tiranës pëlqimin për emërimin e ardhshëm të një peshkopi serb, Viktorit, për pakicën sllave të Shkodrës. Visarioni e parashikonte kundërshtimin që do t'i bënte autoqefalisë Patrikana e Stambollit dhe donte të garantonte mundësinë e një shugurimi episkopal për t'u vënë në krye të Kishës së re Autoqefale Shqiptare. Peshkopi serb ndoshta do mund të rimëkëmbte një hierarki të

vlefshme kanonikisht dhe, siç shpresonte Visarioni, duke filluar nga personi i tij.

Por shembulli i peshkopit serb u sugjeronte edhe grekëve dhe arumunëve të paraqisnin kërkesa për ardhjen e priftërinjve të huaj për pakicat e tyre në Shqipëri. Fanari i inkurajoi kishat autoqefale të Athinës (megjithëse nuk kishte nevojë për këtë), të Bukureshtit e të Beogradit, për të kërkuar caktimin e peshkopëve të tyre në Shqipëri. Autoritetet e Tiranës u frikësuan nga krijimi i një gjendjeje të rënduar, e cila do të ishte më e keqe nga e mëparshmja, pasi kështu, jo vetëm që grekët do të kishin peshkopët e tyre në Shqipëri, të cilët vitet e mëparshme ishin përzënë të gjithë, por edhe jugosllavët dhe rumunët do ta kishin këtë të drejtë.

Se sa e kishin për zemër çështjen e peshkopit sllav të Shkodrës qeveritarët e Beogradit, u vu re kur Tirana, që s'e kishte njohur ende Viktorin, paralajmëroi se do ta largonte atë nga Shqipëria. Jugosllavët kërcënuan se do të ndërprisnin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, gjë që u shmang pas kërkesave që qeveria shqiptare u bëri Romës, Parisit e Londrës për ndërmjetësimin dhe pasi ajo u detyrua të tërhiqej, duke pranuar qëndrimin e Viktorit në Shkodër me cilësinë e "mikut" të Shqipërisë dhe jo si prift i lidhur me Patrikanën Ortodokse Serbe⁴⁵.

Në vitin 1928 baroni De Vo, përfaqësuesi i Francës në Shqipëri, bënte një raport mjaft shqetësues për gjendjen e ortodoksisë shqiptare. Ai përshkruante problemet që shtronte prania e ortodoksëve grekë në Jug dhe e atyre sllavë në Veri, ngecjen e përpyekjeve për afirmimin e autoqefalisë, dobësinë e qartë të qeverisë shqiptare kundrejt problemeve fetare, duke u ndalur pastaj në krizën e brendshme të Kishës Ortodokse Shqiptare⁴⁶. Mirëpo diplomati francez, ndonëse kishte të drejtë për rolin pengues që luanin minoritetet e lartpërmendura ndaj autoqefalisë, nuk ishte i saktë në perceptimin e asaj që ai e quante krizë. Madje edhe ai vetë çuditej dhe nuk arrinte të shpjegonte se si gjithë ortodoksët shqiptarë nuk e kundërshtuan aspak kushtetutën e re të vitit 1928 dhe kodet civile e penale të asaj kohe që shënonin një kthesë historike për Kishën Ortodokse Shqiptare. Po kështu ndodhi edhe me dekretin e 16 korrikut

⁴⁵ R.M. dela Roka, *Kombësia ...*, f. 56-57. Autori i referohet Njoftimit të të Ngarkuarit me Punë të Francës në Shqipëri, Bijëkok për M.P.J. të Francës, më 8 nëntor 1923. AE, Z Europe 1918-1929, Albania, vëll. 50.

⁴⁶ Njoftim i De Vo për MPJ të Francës, 18 prill 1928, në AE, Z Europe 1918-1929, Albania, vëll. 50.

1929 mbi bashkësitë fetare, i cili u pranua dhe zbatua nga ortodoksia shqiptare pa ankesa të dukshme⁴⁷.

Për të plotësuar Sinodin e KOASH, në vitin 1929, Visarioni dhe peshkopi serb Viktori hirësuan tre peshkopë të rinj, pasi më parë qeveria shqiptare i kishte premtuar Viktorit zyrtarizimin e funksionit që kishte kryer deri atëherë si qytetar privat. Më 18 shkurt, një sinod i peshkopëve ortodoksë shqiptarë afirmoi autoqefalinë e kishës së tyre, në krye të së cilës u zgjodh si metropolit, Visarioni.

Fanari kundërshtoi duke u justifikuar se vetëm bashkësitë ortodokse që përfaqësonin shumicën e popullsisë së një vendi kishin të drejtë për autoqefalinë. Ai çkishëroi peshkopët e rinj shqiptarë dhe i deklaroi të shkarkuar. Gjithashtu i kërkoi Patrikanës Ortodokse Serbe të çkishëronte Viktorin.

Në këto momente Athina pretendoi dhe u ankua se pakica greke në Shqipëri ndjehej se i ishte cenuar e drejta për një hierarki kishtare që të kishte gjuhën dhe kulturën e saj⁴⁸.

Ndonëse u bënë shumë përpjekje për konsolidimin e KOASH, përsëri procesi shfaqte vështirësi e probleme. Në Prefekturën e Gjirokastrës meshat vijonin në gjuhën greke edhe në fshatrat ortodokse shqiptare. Vetëm në qytetin e Gjirokastrës dhespoti i bënte meshat në shqip, ndërsa të tjerët gjysmë shqip e gjysmë greqisht⁴⁹. Ndërkohë në shtypin shqiptar të kolonive u bënë kritika ndaj Sinodit të KOASH se “nuk kishte bërë asgjë për të zëvendësuar gjuhën greke me atë shqipe në meshë dhe për të likuiduar influencën greke nga KOASH”. Gazeta “Shqipëria e Re” kërkonte që priftërinjtë në Shqipëri të meshonin vetëm në gjuhën shqipe, ashtu siç vepronin priftërinjtë në kishat shqiptare të kolonive të Amerikës e të Rumanisë⁵⁰. Në këtë kohë, kryesia e KOASH e qortoi Episkopatën e Gjirokastrës se ajo kishte lëshuar certifikata në gjuhën greke dhe e këshilloi që në korrespondencën me grekofonët e asaj dioqeze të vepronte po ashtu si komunikonin edhe funksionarët

⁴⁷ R.M. dela Roka, *Kombësia ...*, f. 60-61.

⁴⁸ *Po aty*, f. 63.

⁴⁹ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1930, dos. 187, fl. 69. Prefekti i Gjirokastrës, Z. Kadarja - MPB, 19 prill 1930.

⁵⁰ A. Ktona, *Gjer kur do meshojmë greqisht?*, “Shqipëria e re”, 16 shtator 1930.

qeveritarë të atij qarku⁵¹. Episkopi u udhëzua që t'ua lëshonte grekofonëve certifikatat në të dyja gjuhët, shqip e greqisht⁵².

Ndërkohë, qeveria shqiptare e gjeti kohën për t'u kujdesur që disa fshatra të veçantë shqiptarë, si ato të Shishtavecit, të cilët si pasojë e sundimit sllav, përveç shqipes flisnin edhe një gjuhë sllave të përzier midis serbishtes e bullgarishtes dhe kishin një identitet shqiptar të mangët, ta përforconin identitetin shqiptar të tyre. Autoritetet e Prefekturës së Kosovës në verë të vitit 1931 bënë një vizitë në këto tetë fshatra dhe diskutuan gjatë me ta, në një frymë miqësore e vëllazërore, për nevojat dhe kërkesat e tyre. Kjo vizitë u prit shumë mirë nga banorët e këtyre fshatrave "pasi ishte e para herë që si nënshtetas shqiptarë panë përkujdesjen e qeverisë"⁵³. Autoritetet e Prefekturës konstatuan se ndërgjegjia e tyre shqiptare po rritej dhe në të gjitha mbledhjet e bisdat që zhvilluan autoritetet me pleqësitë dhe organizatat sportive e rinore të këtyre fshatrave, këto parashtruan me forcë kërkesën për çeljen e shkollave shqipe jo vetëm si nevojë e arsimimit të fëmijëve të tyre "por më tepër sepse banorët e atyre fshatrave dëshironin çrrënjosjen e gjuhës serbe që u kishte mbirë prej kohësh në vatrat e tyre. Ata e quajtën të folmen e serbishtes një fatkeqësi dhe e konsideronin veten si të huaj të përbuzur, të fyer përditë përpara autoriteteve e vëllazërve të tyre shqipfolës"⁵⁴. E inkurajuar së tepërmi nga kjo dëshirë e banorëve të Shishtavecit, Prefektura i kërkoi qeverisë që të merrte masa energjike për çeljen e shkollave shqipe në këto fshatra dhe dërgimin e mësuesve me aftësi të larta profesionale.

Qeveria vijonte të ndiqte me kujdes procesin e konsolidimit të institucioneve dhe të ndërgjegjes kombëtare shqiptare në Himarë. Preokupimin e saj për Himarën e dëshmoi edhe qëndrimi që mbajti ajo kur vdiq nënkoloneli i ushtrisë greke, Spiro Milo nga Himara. Meqë ai ishte i afirmuar për veprimtarinë antishqiptare, Ministria e Brendshme urdhëroi ndalimin e kthimit të trupit dhe varrimin e tij në Himarë dhe në asnjë tokë tjetër të Mbretërisë Shqiptare⁵⁵.

⁵¹ *AQSh*, Fondi: MPB, viti 1930, dos. 187, fl. 81. Kryesia e KOASH - Episkopatës Gjirokastrës, 5 qershor 1930.

⁵² *Po aty*, fl. 112. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 9 korrik 1930.

⁵³ *Po aty*, viti 1931, dos. 155, fl. 7. Prefektura e Kosovës - MPB, Kukës, 7 shtator 1931.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*, dos. 117, fl. 2. MPB - Prefekturës Vlorë, 22 maj 1930.

Qeveria shqiptare ndërmori një aksion tjetër për dobësimin dhe eliminimin e sistemit të venomeve, i cili ende po zbatohet pjesërisht në Himarë. Deri në vitin 1928, popullsia e 7 fshatrave të Himarës i kishte paguar shtetit një sasi prej 20 000 fr. ari në vit për të gjitha taksat. Pas vitit 1928, në bazë të marrëveshjes që bënë himarjotët me qeverinë qendrore, ishte vendosur që shuma prej 20 000 fr. ari që paguanin më parë do të ndahej në tre artikuj të taksave: të dhjetën, vergjinë e xhelepin, të cilat në mënyrë formale dhe në përputhje me Ligjin e të dhjetave do u shiteshin pleqësive të katundeve me çmimin e caktuar. Këta do t'i mblidhnin këto taksa prej popullsisë sipas sistemit të vjetër të venomeve dhe do t'i derdhnin në arkën e shtetit. Të gjitha taksat e tjera shtetërore, si: tatim fitimi, taksa e pijeve, e rugës, e duhanit, istimareja etj., qysh prej vitit 1928 u pranuan nga popullsia dhe u paguan rregullisht prej saj, konform ligjeve shtetërore, ashtu siç veprohej në qarqet e tjera të vendit.

Nga pagesa e 20 000 fr. ari, sipas sistemit të venomeve, kishte një përfitim ekonomik të lehtë popullsia vendase, por më shumë nga ky sistem përfitonin të pasurit dhe paria e tyre.

Në vitin 1931 Ministria e Financave kërkoi që të hiqej edhe ky privilegj dhe të zbatohet sistemi i mbledhjes së të dhjetës, xhelepit e vergjisë si në të gjithë vendin⁵⁶. Por, për të mos cenuar qetësinë e Himarës, autoritetet vendore të xhandarmërisë sugjeruan që ky privilegj të mos u hiqej përnjëherësh, por pak nga pak. Më parë do të zbatohet ligji për taksën e xhelepit e të vergjisë, të cilat përbënin shumën kryesore të tatimeve, dhe e dhjeta për disa kohë të vijonte t'u shitej pleqësive të fshatrave sipas praktikës së deriatëhershme. Më vonë edhe kjo mund të hiqej lehtë nga Ministria e Financave⁵⁷.

Në Himarë qeveria arriti të konsolidonte arsimin në gjuhën shqipe. Këtë e dëshmon edhe tabela e mëposhtme, e cila jep numrin e nxënësve të regjistruar dhe të atyre që frekuentonin shkollat e kësaj krahine në vitin shkollor 1934-1935⁵⁸.

⁵⁶ *Po aty*, dos. 139, fl. 42. Komanda e rrethit të Himarës - Nënprefekturës Himarë, 10 gusht 1931.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*, Fondi: MA, viti 1934, dos. 550, fl. 12.

Shkolla	Klasat	Nxënës të regjistruar	Nxënës që frekuentonin shkollën
Shkolla mashkullore Himarë	5 klasë	135	124
Shkolla femërore Himarë	5 klasë	40	40
Shkolla femërore Dhërmi	5 klasë	56	50
Shkolla mashkullore Dhërmi	5 klasë	157	148
Shkolla e përzier Palasë	5 klasë	57	44
Shkolla Spile	...	27	25

Mirëpo beteja me propagandën greke në këtë krahinë nuk kishte përfunduar dhe nuk ishte fituar plotësisht. Grekomani i njohur Jorgji Bollano, në nëntor të vitit 1934, i kërkoi parisë së Himarës që të zhvillonin një miting, i cili të kërkonte nga qeveria shqiptare shtimin e orëve të mësimit në gjuhën greke në shkollat e Himarës, por ky propozim u refuzua nga paria⁵⁹. Po në këtë kohë, nxënësit e katundit Palasë bojkotuan shkollën dhe prindërit e tyre i kërkuan mësuesit që të jepte mësimin në gjuhën greke, pasi në rast të kundërt, ata do t'i largonin fëmijët nga shkolla⁶⁰. Ministria e Brendshme dha udhëzime që ndaj prindërve të mos merreshin masa ndëshkuese ligjore, por ndaj kërkesave të tyre të mbahej një qëndrim indiferent⁶¹.

Në të vërtetë, në katundin Palasë nuk kishte pasur kurrë shkollë private dhe as mësues privat. Kështu e informonte Ministria e Arsimit, Ministrinë e Brendshme. Në këtë fshat, deri në vitin 1930, mësimi ishte zhvilluar tërësisht në gjuhën shqipe dhe në të gjitha klasat ishin zhvilluar 6 orë greqisht në javë. Qysh nga viti 1930 mësimi i gjuhës greke nuk ishte zhvilluar më, jo sepse ai ishte ndaluar nga Ministria e Arsimit apo nga autoritetet shtetërore, porse nga mosinteresimi i banorëve⁶². Ministria e Arsimit nuk e kundërshtonte rivendosjen e mësimit të gjuhës greke 6 orë në javë, por ishte e shqetësuar se kjo masë do ta nxiste popullsinë e Himarës të kërkonte lëshime edhe më të mëdha dhe mund të rebelohej. Prandaj ajo mendonte se më e përshtatshme ishte mbyllja e shkollës së Palasës, se sa t'u bëhej ndonjë koncesion banorëve të saj. Megjithatë Ministria e Arsimit udhëzoi Nënprefekturën e Himarës që të urdhërohej mësuesi i Palasës të fillonte mësimin e greqishtes 6 orë në javë, ashtu siç

⁵⁹ *Po aty*, dos. 146/1, fl. 95. Prefektura Vlorë - MPB, 4 nëntor 1934.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 196. Nënprefektura Himarë - MPB, 13 nëntor 1934.

⁶¹ *Po aty*, fl. 197.

⁶² *Po aty*, dos. 146/1a. MA - MPB, 17 nëntor 1934.

ishte vepruar para vitit 1930 dhe siç po jepej ajo në qendrën e Himarës dhe në Dhërmi⁶³. Disa ditë më vonë, rreth 100 banorë të katundit Dhërmi kërkuan shtimin e orëve të mësimin në gjuhën greke dhe mësimin e fesë në shkollë. Ato kërcënonin me largimin e fëmijëve nga shkolla⁶⁴. Ministria e Arsimit dha urdhër që greqishtja të mësohej rregullisht 6 orë në javë, ndërsa kërkesa e tyre për mësimin e besimit në shkollë nuk do të pranohej⁶⁵.

Në fund të vitit 1934, si pasojë e përpjekjeve dhe presionit për të shtuar orët greqisht në shkolla, ra frekuentimi i tyre. Kështu në shkollën mashkullore të Himarës nga 145 nxënës të detyruar të vijonin mësimet, shkonin në shkollë 6 nxënës, në shkollën fillore të këtij fshati nga 82 nxënës vijonin shkollën 4 nxënës; në shkollën e përzier Spile nga 77 vijonin mësimin 8 nxënës; në shkollën mashkullore të Dhërmiut nga 164 vijonin mësimet 45; në shkollën femërore të këtij fshati nga 74 vijonin mësimet 18 vajza, dhe në shkollën e përzier të Palasës nga 111 nxënës të regjistruar vijonin mësimet 27 nxënës⁶⁶.

Një çështje tjetër e hapur ishte edhe ajo e gjuhës së meshave në kishë. Në prill 1934, në Komunën e Vunoit meshat ishin bërë tërësisht në gjuhën greke dhe psaltët ishin bërë në dy grupe, në greqisht dhe në shqip. Në gjuhën shqipe kishin kënduar nxënësit e shkollave, kurse në greqisht disa persona që kishin studiuar në Greqi dhe që ishin të frymëzuar nga ndjenja greke. Nënprefektura i kërkonte organeve eprorë që t'i tërhiqej vërejtja administratorit kishtar të atij katundi ose ai të largohej prej andej e të zëvendësohej me dikë që kishte ndjenja kombëtare⁶⁷.

Në këtë debat që po zhvillohej u pushua nga detyra Ikonimi i Himarës, Papa Spiro dhe në vend të tij u emërua Dr. Mihal Cani nga Kudhësi. Pushimi i Papa Spiros u prit me shumë kënaqësi nga shumica e popullsisë së krahinës, pasi ai kishte vepruar në dëm të qeverisë dhe të banorëve, duke provokuar përçarjen e popullsisë në dy grupime: pro qeverisë dhe në antikombëtare. Papa Spiro bashkë me Niko Spiro Milon po përpiqeshin me çdo mënyrë të mbanin të gjallë ndjenjat helenike. Ai kishte përdorur vulën e kishës dhe kishte lëshuar dokumente identiteti në

⁶³ *Po aty*, fl. 229. MA – Nënprefekturës Himarë, 17 nëntor 1934.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 297. Nënprefektura Himarë - MPB, 29 nëntor 1934.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 322. MA - Nënprefekturës Himarë, 8 dhjetor 1934.

⁶⁶ *Po aty*, Fondi MA: viti 1934, dos. 550, fl. 12.

⁶⁷ *Po aty*, Fondi: MPB, viti 1934, dos. 164, fl. 46. N/Prefektura e Bregut të Detit - Prefekturës Vlorë, 14 prill 1934.

gjuhën greke. Ndërsa Mihal Cani cilësohej si një njeri me dinjitet dhe që do të sillte ekuilibër si në kisha, ashtu edhe në popull⁶⁸. Por shpresat se emërimi i M. Canit do të shmangte përçarjen nuk u realizuan. Disa muaj pas emërimit, ai nuk kishte mundur të merrte në dorëzim kishën sepse partia tjetër nuk pranonte ta dorëzonte. Kështu që përçarja kishtare në Himarë po vazhdonte⁶⁹. Në këtë situatë, kryepeshkopi Visarioni riemëroi Ikonomin Papa Spiro në kishën e Himarës. Ai nuk mori parasysh rezultatet e votimit që ishte bërë për këshillin e kishës dhe la në detyrë këshillin e vjetër. Këto masa krijuan pakënaqësi dhe alarm tek shumica e popullsisë, e cila iu drejtua kryepeshkopit me një telegram, se në rast që do të linte në detyrë Papa Spiron dhe nuk do të respektonte rregulloren e kishës, do të detyroheshin të kërkonin një prift katolik⁷⁰. Kështu që situata mbetej e rëndë dhe përçarja vazhdonte.

Shtypi shqiptar vijonte t'i shpjegonte opinionit publik se masat e qeverisë në Himarë i shërbenin forcimit të identitetit kombëtar të vendit. Në shtyp u bënë edhe krahasime me politikën greke. Jorgji Mexi shkruante: "Po a mundet Greqia të njohë gjithashtu të drejtën e shqiptarëve që janë në Menidhi jashtë Athinës, që të mësojnë në gjuhën shqipe? Greqia në këtë çështje mban dy pesha! Vetëm kërkon dhe nuk di të japë. Kjo është një çështje delikate sepse po të plotësohen të gjitha orekset greke bëhet një "poussière d'Etats" sipas fjalës së Briandit, pra jo shtete por një pluhur shtetesh"⁷¹.

Shtypi shqiptar duke komentuar disa lajme se në Shqipëri po hapeshin shkolla fillore me karakter fetar, kritikoi këtë synim të komuniteteve fetare dhe e vlerësoi atë të dëmshëm për unitetin kombëtar. Këto shkolla që e kishin origjinën në kohën e sundimit osman cilësoheshin "si burimi i të gjitha të këqijave, sepse ata i ndanë shqiptarët qysh në vogëli dhe s'i lejuan të bashkoheshin kurrë me gjithë shpirt, duke bërë që tërë jetën ta shihnin njëri-tjetrin me sy të huaji"⁷². U kërkua që kjo eksperiencë e hidhur të mos përsëritej më. Shkollat fillore të ishin vetëm laike dhe të drejtoheshin nga shteti, sepse kështu, dalëngadalë por

⁶⁸ *Po aty*, fl. 80. N/Prefektura e Bregut të Detit - Prefekturës Vlorë, 6 korrik 1934.

⁶⁹ *Po aty*, fl. 133. N/Prefektura Himarë - MPB, 6 tetor 1934.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 138. N/Prefektura Himarë - MPB, 19 tetor 1934.

⁷¹ Jorgji Mexi, *Privilegjet e Himarës*, "Demokratia", 5 mars 1932.

⁷² *Shkollat fillore të komuniteteve dhe uniteti kombëtar*, "Shqipëria e re", 13 nëntor 1931.

me siguri, do të përgatitej uniteti kombëtar i Shqipërisë së nesërme. Gjithashtu në shtyp u kritikua tolerimi i fenomenit të studimit në shkollat e shteteve fqinje dhe preferenca që u jepej në punësim në administratën shtetërore këtyre nxënësve që mbaronin ato shkolla⁷³.

Lufta politike e brendshme në disa raste evidentoi edhe dobësi në formimin politik kombëtar, i cili u shfaq në akuzat ekstreme për ndërgjegjen kombëtare të dyshimtë të palëve në debat. E tillë ishte polemika e Faik Konicës dhe e “Diellit” me Mihal Lehovën dhe në gazetën “Shqipëria e re”. F. Konica sulmoi Koço Kotën si autor i memorandumit separatist të disa krerëve korçarë. Gazeta “Shqipëria e re” mori në mbrojtje Koço Kotën, duke e justifikuar se qëllimi politik i tij kishte qenë që “ta shndërronte problemin e ortodoksëve në një çështje të brendshme të vendit dhe ta shkëpuste atë njëherë e mirë nga duart e Marrëveshjes së Korfuzit, që ajo të mos ishte një lodër e miqve të dhespotëve grekë dhe të Vardhës”⁷⁴. Faiku akuzohej se kishte veshur petkun e ultranacionalistit dhe po vepronte si një spiun dhe agjent i të huajve, se kishte përçarë shqiptarët e Amerikës në të krishterë dhe muhamedanë. Gazeta protestonte se Faiku e kishte akuzuar drejtorin e saj si “çoban Maqedonie”⁷⁵. Gazeta merri në mbrojtje edhe Koço Kotën dhe akuzonte gazetën “Dielli” se po nxiste fanatizmin fetar⁷⁶. Ajo e cilësoi Koço Kotën si “autorin e shkëlqyer të Kishës Autoqefale Shqiptare” dhe si një patriot të ndershëm dhe të panjolllosur. Ajo akuzonte edhe “Vatrën” se po punonte për shkatërrimin e shtetit shqiptar⁷⁷.

Edhe në vitin 1931 vijuan polemikat midis “Republikës” dhe “Diellit”, të cilat reflektonin, përveç të tjerash, edhe një krizë identiteti. “Republika” denonconte si Koço Kotën që ishte kryetar i Parlamentit se “kishte organizuar partinë e kaurëve të shtypur kundër turqve që kishin fuqinë në dorë”, por edhe “Vatrën” që “ishte bërë strofka e myslimanëve kristianofobë” dhe “Diellin” që ishte bërë “tribuna zyrtare e fanatizmit myslimanë”⁷⁸. “Tafari Koço Kotist” akuzohej se po grumbulloste rreth tij

⁷³ Ç’na duhen shkollat tona kur po preferojmë absolventet e shkollave të huaja?, “Besa”, Tiranë, 26 korrik 1932.

⁷⁴ F. Konica i xhindosur flet me anë të “Diellit”, “Shqipëria e re”, 9 shtator 1930.

⁷⁵ Xhixhëllesa e Llagëmeve, “Shqipëria e re”, 19 gusht 1930.

⁷⁶ “Dielli” dhe Faik Konica, “Shqipëria e re”, 19 gusht 1930.

⁷⁷ Cili është Faik bej Konica?, “Shqipëria e re”, 26 gusht 1930.

⁷⁸ “Republika”, 26 nëntor 1931.

gjithë grekomanët e memorandumistët myslimanofobë, ndërsa “Gazeta e Korçës” dhe “Shqipëria e re” denoncoheshin se po ushqenin me sistem fanatizmin e krishterë. Kështu, dalëngadalë, ata po hapnin përsëri plagët e vjetra në trupin e popullit shqiptar dhe populli po përçahej dhe po mbetej rob i bejlerëve, i agallarëve dhe i arkondëve.

“Republika” akuzonte Faik Konicën se po udhëhiqte këtë “politikë të ndyrë e reaksionare”, që bazohej mbi paragjykimet fetare. Ai cilësohej si “politikani me njëqind faqe e njëqindnjë vizhdane, myslimani i pagëzuar, anarkisti absolutist, socialisti borgjez, demokraci fashist, republikani monarkist, moralisti edepsëz”, i cili po e bënte këtë politikë në favor të regjimit zogist⁷⁹. F. Konica cilësohej si avokat i vorioepirotëve sepse kishte nxitur botimin në gazetën “Dielli” të librit të Kostandin Skënderit, një kryetar i Lëvizjes Vorioepirote, i cili fliste dhe shpifte për krimet e të krishterëve të Gjirokastrës e të Korçës kundër shqiptarëve myslimanë. Artikulli denonconte edhe luftën që kishte filluar F. Konica dhe gazeta “Dielli” kundër kucovllahëve. Ai e quante këtë “një taktikë prej intriganti të paskrupullt dhe të një provokatori shejtanbudalla, sepse “kucovllahët” e Faikut nuk ishin as çobanët e Pindit, as rumunët e Korçës, që bëheshin gjithsej nja 200 shtëpi dhe që kishin qenë më të shumtët përkrah nacionalistëve shqiptarë kundër imperialistëve grekë”. Por “kucovllahët”, për të cilët bënte fjalë libri i Skënderit, ishin të krishterët shqiptarë të Himarës, të Lunxhërisë, të Zagorisë, të Gjirokastrës, të Përmetit, të Kolonjës, të Devollit e të Korçës, të cilët ishin pagëzuar si kucovllahe dhe u ishin ngarkuar në kurriz gjithë turpet dhe krimet e autonomistëve të vitit 1914. “Republika” shkruante se, kështu, Faiku do t’u thotë shqiptarëve myslimanë: “Ja këta “kucovllahë” gjizëbërës e tradhtarë prej natyre, këta ju kanë rrjepur shtëpitë, ju kanë rrëmbyer mallin e gjënë, ju kanë masakruar fëmijët, ju kanë çnderuar bijat e gratë. Këta kucovllahë sot e kanë shtetin në dorë. Këta e vdesin popullin shqiptar për bukë! Po të shfarosen këta, punët e Shqipërisë do të venë mbarë. Luftoni pra kundër këtyre dhe jo kundër bejlerëve”⁸⁰. Lame Kodra e quante këtë qëndrim të Faikut në interes të regjimit reaksionar, i cili donte që të ndërseheshin myslimanët mendjendryshkur kundër të krishterëve shqiptarë dhe të krishterët mendjendryshkur kundër myslimanëve. Ai nënvizonte se vegjëlja punëtore shqiptare bashkë me

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Po aty.

kucovllahët, shumica e madhe e të cilëve ishin bujq, barinj e zanatçinj të ndershëm, nuk do të binin kollaj në leqet e reaksionarëve intrigantë.

Gazeta “Republika” e bazoi kritikën kundër F. Konicës edhe në parime dhe koncepte klasore. Lame Kodra shkruante se vegjëlja punëtore e krishterë e Shqipërisë së Jugut, ashtu si dhe vegjëlja punëtore myslimane, kishin vuajtur shumë nga bejlerët, agallarët e agjentët e tyre. Kështu vegjëlja ortodokse nuk kishte rrugë tjetër shpëtimi, përveç bashkimit me Greqinë. Ndërsa kleri ortodoks grekoman dhe paria e krishterë grekomane gjetën shesh në të kaluarën për propagandën e tyre reaksionare. Nga ana e saj edhe paria e krishterë e Shqipërisë së Jugut, tyxharët e fajdexhinjtë kishin rrjepur gjithnjë e po grabisnin, në saje të regjimit reaksionar, vegjëljinë punëtore të krishterë dhe myslimane. Këta ai i denonconte se ishin aleatë të regjimit “feudal-fashist” të Zogut dhe se krerët grekomanë duheshin luftuar dhe jo vegjëlja punëtore e krishterë që ishte marrë në qafë prej parësisë dhe prej priftërinjve grekomanë⁸¹. Ai kritikonte F. Konicën se i fuste në një “thes” të gjithë të krishterët dhe se i pagëzonte “kucovllahë”, duke ua hedhur si prehë fanatikëve myslimanë dhe se po bënte pikërisht atë gjë që po bënin grekomanët kundër shqiptarëve myslimanë. Ai shkruante: “Faik beu e Koço Kota punojnë për një qëllim dhe hanë në një grazhd. Faik Konicat e Koço Tasët duan që populli punëtor shqiptar të nisë përsëri këtë histori mesjetare (përçarjen fetare - B.M.) të errët e të përgjakshme, sepse ashtu ua do interesi bejlerëve, agallarëve, arkondëve dhe imperialistëve grekë e italianë. Populli shqiptar duhet të përçahet në “turq” e “kaurë” dhe të nisë të qërojë hesapet e vjetra që po i tregojnë ditë për ditë “Pellasgos” i Skënderit në Athinë dhe “Dielli” i Faik Beut në Boston ... Kryetarët e grekomanëve të Korçës e të Gjirokastrës janë sot shtyllat më të shëndosha të regjimit zogolljan në Jug, tamam si kryetarët e turkomanëve që janë shtyllat më të shëndosha në Veri”⁸². Polemikata e lartpërmendura megjithëse karakterizohen nga ekstremizmi politik, po të analizohen me kujdes evidentojnë disa probleme të mprehta politike, sociale dhe kombëtare në përbërjen dhe në mentalitetin e një pjese të elitës politike e intelektuale të vendit, pastrimi i së cilës nga mendësitë dhe paragjykimet

⁸¹ Lame Kodra (Sejfulla Malëshova), *Ca fakte e ca pyetje për Faik bej Konicën*, “Republika”, 7 janar 1932.

⁸² *Po aty*.

e së kaluarës ishte një imperativë e domosdoshme për konsolidimin e shtetit kombëtar.

Vendimi i Lidhjes së Kombeve për shkollat greke nxiti ndjenjat dhe aspiratat grekomane, të cilat deri në këtë kohë dukej se ishin dobësuar. Prefektura e Korçës konstatonte se “pjesa grekomane e qarkut të Korçës e ka përkrahur në heshtje kërkesën e grekofonëve të Gjirokastrës, megjithëse ata e çmojnë se ky vendim nuk mund t’u sigurojë atyre një përfitim të njëjtë. Por është zgjuar shumë interesi për të krijuar, nën këtë maskë, privilegjet që ka pasur elementi ortodoks qysh në kohët e kaluara, si në pikëpamje të formimit të ndjenjave të tyre grekofile me anën e mësuesve të tyre të lirë fetar, ashtu dhe për të siguruar një autoritet më të rrënjosur dhe më të gjerë, me qëllim që, me këto avantazhe të shkatërrojnë sistemin e sotëm të Kishës Autoqefale Kombëtare, e cila pengon sigurimin e privilegjeve dhe gjërave të tjera që ka pasur më parë elementi ortodoks dhe dogma e tyre”⁸³. Prefektura informonte se tani këto elementë grekomanë kishin filluar të ndihmoheshin edhe prej një pjese të klerit, në krye të të cilit qëndronte edhe episkopi i Korçës, Kissi dhe qarqet grekomane “filluan me efektuar edhe në qarqe patriotike, të cilat, megjithatë, nuk kanë arritur të shprehen në favor të tyre dhe as që besohet një gjë e tillë”⁸⁴. Por, të influencuar nga avantazhet që u predikonte imzot Kissi, këto qarqe mendonin se do t’u sigurohej ndonjë privilegj më i gjerë fetar dhe ishin larguar në mënyrë të dukshme nga qëndrimi i tyre i mëparshëm (patriotik), dhe për rrjedhojë, kishin shfaqur një ftohtësi, e cila pak kohë më parë nuk kishte qenë as e ndjerë dhe as e deklaruar. Prefektura pohonte se këtë bindje e kishte formuar nga disa ngjarje. Njëra prej tyre ishte zgjedhja e parisë së shoqërisë “Rinia korçare”, gjatë së cilës elementi ortodoks ishte shprehur në mënyrë të dukshme në favor vetëm të kandidatëve ortodoksë, pa marrë parasysh inferioritetin ose superioritetin moral e kulturor dhe as përshtypjen që do të bënte zgjedhja e një partie të përbërë vetëm prej elementit ortodoks, qëndrim, i cili deri pak kohë më parë, ishte luftuar gjithmonë nga patriotët ortodoksë⁸⁵.

Një pjesë e patriotëve ortodoksë vërtet kishin zhvilluar disa kohë më parë një përshpirtje në favor të Kishës Unite, por ky qëndrim nuk

⁸³ *AQSh*, viti 1935, dos. 399, fl. 199-202. Prefektura e Korçës - MPB, 12 qershor 1935.

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ *Po aty*.

kishte qenë rezultat i besimit të tyre, por prej mërisë personale që ushqenin për kryetarin e KOASH-it, Visarionin, ekzistencën e të cilit në atë pozitë të lartë fetare e konsideronin si diskreditim për besimin ortodoks. Prefektura informonte se aktiviteti i fshehtë i imzot Kissit dhe predikimet e tij nën maskën fetare, po i sillnin një dëm të madh “kolektivitetit shoqëror e vëllazëror të elementëve të Korçës”. Ajo dyshonte se me këto qëndrime dhe me njerëzit që ai kishte afruar pranë vetes, synonte të frymëzonte popullsinë ortodokse për “t’ia arritur ndonjë qëllimi të lig kundër sistemit ekzistues të KOASH”. Për këtë arsye ajo propozonte transferimin e tij nga qarku i Korçës dhe zëvendësimin e tij me Atë Vasil Markon, derisa të kthehej gjendja e mëparshme, domethënë “besimi e kënaqësia ndaj kishës dhe dashuria midis elementëve të ndryshëm”⁸⁶.

Vera e vitit 1935 shënon një kufi kohor të rëndësishëm, i cili përmbyll një periudhë historike, ku me gjithë vështirësitë që i trajtuam në mënyrë të detajuar më lart, shteti shqiptar ishte në aksion të vazhdueshëm për të kapërcyer problematikën e vështirë dhe delikate që dilte para tij për formimin e konsolidimin e kombit shtet. Në këtë betejë tepër të vështirë u arritën një sërë suksesesh, shumë më tepër se në çdo periudhë tjetër historike, por nga ana tjetër pati edhe mjaft dështime, të cilat lidheshin me faktorë të karakterit objektiv, si: presioni i fuqishëm që vinte nga fqinjët apo nga disa organizma ndërkombëtare, si dhe nga trashëgimia që vinte prej së kaluarës, e cila kishte lënë rrënjë të thella në ndërgjegjen e disa grupeve të popullsisë. Por pati edhe probleme që u krijuan nga gabimet në trajtimin e këtyre çështjeve tepër delikate dhe të ndjeshme. Sidoqoftë dukej se shteti shqiptar po ecte në rrugë të mbarë drejt unifikimit kombëtar dhe konsolidimit të tij, por procesi ishte ende i papërfunduar.

⁸⁶ *Po aty.*

*S u m m a r y*THE ENDEAVOURS FOR THE NATIONAL INSTITUTION'S
CONSOLIDATION (1925-1935)

During the 20-30 ties of the XX century, presuming by a relatively stable period Albania made serious efforts to complete and consolidate the national state. The Albanian government paid attention to the development and nationalization of a number of important institutions as the perfection of the consolidation of educational system and the strengthening of its national character. The entire process was developed in a continuous confrontation with two strong preclusive factors. Firstly the Albanian government had to fight with the past inheritance, where the country has been under the Ottoman Empire when the Albanian national institutions as education, church etc were forbidden and the population had been under the influence of the Greek school and church firstly, and secondly a real political, diplomatic judicial and propaganda with the neighbour governments of Balkan countries and some organisms that were under their influence, which made efforts to keep the old system of the Ottoman period, which prohibited the constructions process of the national state in Albania, All this battle was carried out trying to define the Albanian orthodox population as a national minority and to impose the Albanian state the decentralized specific politics.

In this process the Albanian government was faced with the improvement challenge, modernization and the strengthening of the national educational system in order to be competitor towards the Greek school in the southern Albania and towards the foreign schools. It achieved some positive results in this direction. But Greek competition continued and Greece funded in conspiracy Greek education between Albanian people in Southern Albania. Another battle was held for the autocephaly church. Not throwing away institutionally its autocephaly proclamation Greece and the circles under its service in Albania were trying to prohibit the introduction of the Albanian language in the religious rite and were trying to re-establish the usage of the Greek language in those churches where Albanian language was used.

In this issue Greek government was implied as well which has tried to use the existence of the Montenegrin minority in Vraça of Shkodra to appoint a bishop in the Synod of the Albanian Autocephaly Church.

During 1925-1935 a consistent policy continued, as well as the weakening and elimination of the venom in Himara and the extension of the unique legislation there. In this action the Albanian government was encountered with Greek pressure.

The decision of Hague Court in 1935 for the permit of Greek private schools in Greek minority stimulated Hellenistic feelings and aspiration in some philogreek circles which seemed to have been fading away.